

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		10/12/2025	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
13-060/04-52338			



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
 Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë



Datë/a:	09.12.2025
Për:	Zyrën e Informimit
CC:	Në dosje dhe arkivit
Nga:	Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë
Tema:	Procesverbal nga Shqyrtimi Publik të Draft-Planit për Vlerësimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera dhe Planit të Reagimit Emergjent

PROCESVERBALI

Takimi publik për Draft - Planin për Vlerësimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera dhe Planin e Reagimit Emergjent u mbajt më datë 04.12.2025 në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 11:00 deri në 12:00.

Mbledhja u shpall e hapur nga z. Bekim Dobra, i cili prezantoi rendin e ditës dhe punën e ekipit punues. Ai theksoi se njoftimi publik për dokumentet është bërë me kohë dhe se të gjithë palët e interesuara kanë pasur mundësi të paraqesin komentet dhe sugjerimet e tyre.

Më tutje me fjalë rasti:

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Nexhmedin Gruda, foli para të pranishmëve lidhur me rëndësinë që këto dy dokumente strategjike kanë për zhvillimin e qëndrueshëm të komunës dhe avancimin e politikave për planifikimin e hershëm të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe rëndësinë e hartimit të planit të reagimit emergjent. Gjithashtu, falënderoj ekipin komunal për angazhimin dhe punën e bërë në draftimin e këtyre dy dokumenteve me rëndësi të madhe për komunën e Drenasit.

Ndërsa shefi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Afrim Prokshi, para të pranishmëve ka prezantuar në pika të shkurtër dy dokumentet dhe ka treguar se afati për dhënien e komenteve, ende mbetet i hapur deri me datën 08.12.2025, ndërsa pas këtij afati dokumentet do të përmbyllecen dhe do të dërgohen në Kuvend për miratim.

Plani për Vlerësimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera 2025-2029 objektivë kryesore ka:

- Parandalimin – të identifikohen burimet e mundshme të rreziqeve (si tërmetet, përmytjet, rrëshqitjet e tokës, aksidentet teknologjike, etj.) për të marrë masa që minimizojnë mundësinë e ndodhjes së tyre.
- Reduktimi i pasojave - të analizohen ndikimet e mundshme në njerëz, pasuri dhe mjedis, në mënyrë që të planifikohen veprime në rast se fatkeqësia ndodh.
- Rritje e përgatitjes – të përgatitë institucionet, komunitetin dhe personelin për t'u përgjigjur në mënyrë efektive në rast emergjence.
- Planifikimi i masave parandaluese dhe mbrojtëse – të përcaktohen masa teknike, organizative dhe edukative që duhet të ndërmerren për të përballur rreziqet e identifikuar.
- Sigurimi vazhdimësisë së veprimtarisë - të garantojë që institucionet (p.sh. shkolla, komuna, kompani) mund të vazhdojnë funksionimin e tyre edhe pas një fatkeqësie, me dëme minimale.

Plani i Reagimit Emergjent 2025-2029 përcakton këto objektiva kryesore:

- Të garantojë veprim të organizuar dhe të koordinuar të personelit dhe institucioneve përkatëse gjatë emergjencave.
- Të mbrojë jetën dhe shëndetin e njerëzve përmes evakuimit të sigurt dhe ndërhyrjeve të menjëhershme.
- Të minimizojë dëmet materiale dhe mjedisore që mund të shkaktohen nga emergjencat.
- Të përcaktojë rolet, përgjegjësitë dhe zinxhirin e komandës për të shmangur konfuzionin gjatë reagimit.
- Të sigurojë komunikim të efektshëm ndërmjet punonjësve, drejtuesve dhe shërbimeve të jashtme të emergjencës (Zjarrfikës, Ndihmë e Shpejtë, Polici, etj.).

- Të krijojë kushte për rikthimin e shpejtë në gjendje normale pas përfundimit të emergjencës.

Takimi përfundoj pa debat dhe pyetje eventuale.

Platformat ku është publikuar njoftimi për konsultim publik:

Web faqja zyrtare e Komunës së Drenasit:

<https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/11/20251119150208921.pdf>

Plani për Vlerësimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera 2025-2029 –

Web faqja zyrtare e Komunës së Drenasit:

<https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/11/VLERESIMI-I-RREZIQEVE-NGA-FATKEQESITE-NATYRORE-DHE-FATKEQESITE-TJERA-PER-KOMUNEN-E-GLLOGOCIT-2026-2029.pdf>

Plani i Reagimit Emergjent 2025-2029:

Web faqja zyrtare e Komunës së Drenasit

<https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/11/PLANI-I-REAGIMIT-EMERGJENT-PRE.pdf>

Rrjeti social Facebook i Komunës së Drenasit: <https://www.facebook.com/komunadrenas>

Dokumentet e bashkëngjitura:

Njoftimi për organizimin e dëgjimit publik

Lista e pjesëmarrësve

Raporti është përgatitur nga:

Bahtije Spahiu

Zyrtare për Menaxhimin e Mbeturisë

